

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin penal të përbërë nga gjyqtarët Shqipe Qerimi, kryetare e kolegjit, Afrim Shala dhe Ferit Osmani, anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Kimete Veseli, si procesmbajtëse, në çështjen penale ndaj të akuzuarit R.M., nga Mitrovica, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik, nga neni 297 paragrafi 5 lidhur me paragrafin 1 dhe 3 të Kodit Penal të Kosovës (KPK), duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, PP.II.nr.4097-11/2010, të datës 4 prill 2018 dhe ankesës së avokatit të akuzuarit R.M., avokatit Sh.A., të datës 16 prill 2018, të paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.3259/12, i datës 20 shkurt 2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 13 qershor 2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.3259/12, i datës 20 shkurt 2018, VËRTETOHET.

II. HUDHET si e paafatshme ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit R.M., avokatit Sh.A..

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktgjykimin e lartcekur, të akuzuarin R.M., e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik, nga neni 297 paragrafi 5 lidhur me paragrafin 1 dhe 3 të KPK dhe të njëjtin për këtë vepër penale e ka dënuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari nuk kryen vepër tjetër penale për kohën e verifikimit në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Është detyruar i akuzuari R.M., që t'i paguaj shpenzimet e procedurës penale aq sa kanë qenë sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës së shkallës së parë dhe në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 50 € (pesëdhjetë Euro), në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

E dëmtuara H.E., nga fshati ..., Komuna e Obiliqit, për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullt civil juridik.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor kanë paraqitur ankesë:

- Prokuroria Themelore në Prishtinë, për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, duke i propozuar Gjykatës së Apelit të Kosovës, që ta aprovojë ankesën si të bazuar, kurse aktgjykimin e ankimuar ta anuloj dhe çështjen ta kthen në rigjykim apo të njëjtin ta ndryshoj, ashtu që ndaj të akuzuarit të shqiptohet një dënim më i rëndë me burgim efektiv dhe

- mbrojtësi i të akuzuarit R.M., avokati Sh.A., për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit mbi dënimin, duke i propozuar Gjykatës së Apelit të Kosovës që ta aprovojë ankesën e mbrojtësit të të akuzuarit si të bazuar, ndërsa ta anulojë aktgjykimin e shkallës së parë, ose ta ndryshojë aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, ashtu që i akuzuari R.M., të lirohet nga përgjegjësia penale.

Prokuroria e Apelit e Kosovës, me parashtresën PPA/II.nr.380/2018, e datës 20 prill 2018, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, kështu që të ndryshohet aktgjykimin i ankimuar dhe ndaj të të akuzuarit të shqiptohet një dënim me burgim efektiv, ndërsa me parashtresën e datës 7 maj 2018, ka propozuar që ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit R.M., avokatit Sh.A. të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata e Apelit e Kosovës, pasi mbajti seancën e kolegjit, shqyrtojë shkresat e lëndës, analizoi aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), konstatojë se :

- ankesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, është e pabazuar, ndërsa ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit është e paafatshme.

Në ankesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, theksohet se dënimi i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë ndaj të akuzuarit R.M., nuk i përgjigjet shkallës së rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale për të cilën është shpallur fajtor dhe shkallës së përgjegjësisë penale të tij, duke e marrë parasysh dënimin e parashikuar për këtë veprë penale. Me dënime të tilla të kushtëzuara nuk do të arrihet qëllimi i dënimit, i parashikuar në nenin 41 të KPRK. Gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të dënimit kishte marrë parasysh disa rrethana lehtësuese, mirëpo nuk e kishte patur parasysh faktin se i akuzuari nuk e kishte pranuar fajësinë për këtë veprë penale dhe as që ishte penduar për të njëjtën. Andaj, duke u bazuar në këto rrethana, në ankesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë është propozuar që ankesa

të aprovohet si e bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim, ose aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, ashtu që ndaj të akuzuarit të shqiptohet dënim me burgim efektiv.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, pretendimi i lartcekur i paraqitur në ankesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë për shqiptimin e dënimit me burgim efektiv është i pabazuar. Gjykata e shkallës së parë drejtë i ka konstatuar dhe vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, siç parashihet në nenin 64 të KPK. Në këtë aspekt, si rrethana lehtësuese për të akuzuarin R.M. gjykata e shkallës së parë e kishte marrë për bazë faktin se i akuzuari për herë të parë kishte rënë ndesh me ligjin, se kishte kaluar një kohë e gjatë nga koha e kryerjes së veprës penale, sjelljen e të akuzuarit në gjykatë, se tani i njëjti është pensionist dhe ka gjendje të dobët ekonomike, ndërsa nuk kishte gjetur ndonjë rrethanë rënduese për të njëjtin.

Gjykata e Apelit e Kosovës, vlerëson se duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat të cilat i ka konstatuar edhe gjykata e shkallës së parë, dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit R.M. është në harmoni me peshën e veprës penale, me intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i parashikuar me nenin 34 të KPK, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, si dhe të përmbajë persona tjerë nga kryerja e veprave penale. Andaj, duke vlerësuar të gjitha rrethanat e lartcekura, pretendimi i Prokurorisë Themelore në Prishtinë është i pabazuar, ngase dënimi i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë ndaj të akuzuarit duke i marrë për bazë rrethanat e lartcekura është dënim i drejtë dhe i ligjshëm.

Sa i përket ankesës së mbrojtësit të të akuzuarit, avokatit Sh.A., Gjykata e Apelit e Kosovës konstaton se e njëjta është e paafatshme. Kjo për faktin se nga shkresat e lëndës shihet se në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë i akuzuari R.M. e ka pranuar më datën 29 mars 2018, ndërsa mbrojtësi i tij, avokati Sh.A. ankesën e ka dorëzuar në gjykatën e shkallës së parë me datën 16 prill 2018. Në nenin 478 paragrafi 4 të KPP, është parashikuar se “në qoftë se i pandehuri ka mbrojtës, shkresa nga paragrafi 2 i këtij neni (aktakuza, aktgjykimi dhe vendimet tjera për të cilat afati ankesës fillon nga dita e dorëzimit, duke përfshirë edhe ankesën e palës kundërshtare të dorëzuar për përgjigje) i dërgohet mbrojtësit dhe të pandehurit, në pajtim me dispozitat e nenit 477 të KPP. Në rastin e tillë, afati për ushtrimin e mjetit juridik apo të përgjigjes në ankesë rrjedh nga dita e dorëzimit të shkresës së pandehurit. Ndërsa, në nenin 380 paragrafi 1 të KPP, është parashikuar se ”kundër aktgjykimin të marrë nga gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues i gjykatës themelore, ankesën mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimin”. Duke u bazuar në të gjitha këto që u ceken më lartë, shihet që ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit është paraqitur pas kalimit të afatit ligjor.

Duve vepruar sipas detyrës zyrtare, në kuptim të nenit 394 të KPP, Gjykata e Apelit e Kosovës, e shqyrtojë aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë edhe sa i

përket shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljeve të ligjit penal dhe konstatojë se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij dhe as shkelje të ligjit penal në dëm të të pandehurit.

Duke u bazuar në këto që u tha më lartë e në bazë të neneve 401 dhe 399 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Departamenti i Përgjithshëm
PA1.nr.372/2018, Më 13 qershor 2018

Bashkëpunëtorja profesionale,
Kimete Veseli

Anëtarët e kolegjit:
Afrim Shala

Kryetare e kolegjit,
Shqipe Qerimi

Ferit Osmani